



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**



RAPORT TREMUJOR
(prill – qershor 2023)

**PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E KOORDINATORIT
KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMIT EKONOMIK**

Prishtinë, gusht 2023

1. HYRJE – Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit, të dizajnuara për të arritur dhe për të mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimit Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë joformale;
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit apo efektivitetit të programit,
9. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe do të përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.
12. Koordinatori Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi “Procedurat Standarde të Veprimit për përzgjedhjen e shënjestrave të krimeve të rënda dhe bashkëpunimi ndërinstytucional”;

13. Koordinator Kombëtar po ashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018”.

Prokurori Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

2. ANALIZA&SUKSESET

Periodha e dytë e vitit 2023, prill – qershor, sjell rezultatet më të mira ndonjëherë që ka pasur sistemi i drejtësisë. Këtë e ilustron më së miri fakti se kemi 257,320.45 € pasuri të sekuestruara, 62,794,963.98 € pasuri të ngrira dhe 3,557,891.64 € pasuri të konfiskuara.

Vetëm kjo periudhë ka më shumë konfiskim se sa madje 5 vitet e fundit së bashku. Në 5 vitet e fundit, sistemi i drejtësisë në Kosovë ka raportuar konfiskime në vlerë prej më pak se 3 milionë euro, ndërsa vetëm këtë tremujor ka më shumë se 3.5 milionë euro konfiskim përfundimtar, që flet për një sukses të jashtëzakonshëm.

Meritat kryesore shkojnë para së gjithash tek puna e prokurorëve Merita Bina Rugova, Valdet Gashi dhe Besa Limani. Vlen të potencohet se rasti i Merita Bina Rugovës paraqet rastin më të madh në historikun e Prokurorit të Shtetit, sa i përket shifrave të konfiskimit, kuptohet gjithnjë nëse rastet e tilla do të verifikohen edhe nga Gjykata Supreme, nëse eventualisht dërgohen atje.

Në të kaluarën ka pasur raste kur janë raportuar raste me konfiskim që kanë kaluar vlerën e 1 milion eurove, mirëpo edhe kur ka ndodhur kjo, ka qenë përgjatë një viti, ndërsa këtë tremujor kemi mbi 3.5 milionë euro pasuri të konfiskuara përfundimisht, në 3 raste, ku njëri rast vjen nga PTH Prishtina ndërsa 2 raste tjera vijnë nga PSRK. Vlen të përmendet se rastet e fundit, pra ato nga PSRK, paraqesin raste vërtet të mëdha dhe të rëndësishme. Në këto raste pra tashmë kemi aktgjykimet nga Gjykata e Apelit, vendime këto që konsiderohen të ekzekutueshme.

RASTET E KONFISKIMIT:

1. Kështu, rasti i parë evidentohet nën shifrat PP.I.nr.698/2022, aktakuzë e ngritur me datë 24.01.2023, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267.2 të KPRK-së (prokurorja e rastit – Besa Limani). Në këtë rast kemi një të pandehur, Z. H, shtetas i huaj.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR..nr.50/2023, i datës 09.02.2023 dhe numri i dokumentit: 03957031.

Gjykata e Apelit, me aktgjykimin, PAKR.nr.94/2023, të dt. 02.03.2023, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

Me këtë rast, gjykata ka vendosur që të konfiskoj automjetin e tipit Minibus Mercedes 310 D, një telefon të tipit IPHONE 7, një telefon të tipit NOKIA, para në shumë prej pak mbi 1,000.00 € (euro, funta angleze, lek shqiptare).

2. Rasti i dytë evidentohet nën shifrat PPS.nr.59/2019, aktakuzë e ngritur me dt. 12.09.2020, kundër të pandehurit H.P., për shkak të veprave penale, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdim, nga neni 262 paragrafi 1 lidhur me nenin 81, veprës penale të mashtrimit në vazhdim nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me nenin 81, mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374.1 dhe veprës penale të shpëlarjes së parave nga neni 302 të KPRK-së e lidhur me nenin 56.1 pika 1.1 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (prokurorja e rastit Merita Bina Rugova).

Në gjykatë rast evidentohet nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.36/2020, i datës 10.01.2023 dhe numri i dokumentit: 04168745.

Me këtë rast, gjykata ka vendosur që të konfiskoj:

1. Veturën e tipit Mercedes, viti i prodhimit 2019,
2. Veturën e tipit Shkoda, viti i prodhimit 2014,
3. Veturën e tipit Golf, viti i prodhimit 2015,
4. Veturën e tipit Audi A7, viti i prodhimit 2018,
5. Veturën e tipit Land Rover, viti i prodhimit 2018,
6. Veturën e tipit Renault Megane, viti i prodhimit 2018,
7. Veturën e tipit Touran, viti i prodhimit 2016,
8. Veturën e tipit Golf, viti i prodhimit 2009,

9. Ngastrat kadastrale me sipërfaqe prej: 530 m² ku janë ndërtuar objekte afariste me sipërfaqe prej 1072 m², ngastra kadastrale në sipërfaqe prej 5650 m² me shtëpi dhe oborr, ngastra kadastrale me sipërfaqe prej 3256 m², dy lokale me sipërfaqe prej 174 m² dhe 92 m².

Gjykata e Apelit, me aktgjykimin, APS.nr.23/2023, të dt. 05.06.2023, ka refuzuar ankesat e PSRK-së dhe të pandehurit dhe mbrojtësve të tij dhe ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

3. Rasti i tretë evidentohet nën shifrat PPS.nr.88/2020, aktakuzë e ngritur me dt. 12.10.2021, kundër të pandehurve L.G, K. Sh., për shkak të veprave penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 2 dhe paragrafi 3 pika 4 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së, hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 327 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, vjedhjes së identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336.1 të KPRK-së, ndihmë nga neni 32 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së dhe veprës penale të shpëlarjes së parave nga neni 302 të KPRK-së e lidhur me nenin 56.1 pika 1.1 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (prokurori i rastit Valdet Gashi).

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/2021, i datës 07.12.2022 dhe numri i dokumentit: 03924290.

Me këtë rast, gjykata në bazë të nenit 92 të KPRK-së dhe neneve 276 e 278 të KPP-së, ka vendosur që të konfiskoj:

1. Para të gatshme në shumën prej 411,075.22 €, edhe atë nga 21 subjekte, palë të treta, si mjete që rrjedhin nga aktiviteti kriminal i të pandehurve dhe paratë në fjalë janë kthyer në buxhetin e Republikës së Kosovës,
2. Para të gatshme në shumën prej 532,507.18 €, nga 19 subjekte, palë të treta, si mjete që rrjedhin nga aktiviteti kriminal i të pandehurve dhe paratë në fjalë janë kthyer në llogarinë e mirëbesimit që është hapur në emër të Gjykatës Themelore të Prishtinës e të cilat do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës,
3. Veturën e tipit Audi A4,
4. Veturën e tipit Audi A5,
5. Veturën e tipit Audi A5,
6. Veturën e tipit Taureg.

Të pandehurit të parë, gjykata i ka shqiptuar dënim me burgim prej 11 viteve, dënim me gjobë në shumë prej 8,500.00 € dhe dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për periudhën 6 vjeçare, ndërsa të pandehurit të dytë i ka shqiptuar dënim me burgim prej 10 viteve dhe dënim me gjobë në shumë prej 33,000.00 €.

Gjykata e Apelit, me aktgjykimin, APS.nr.19/2023, të dt. 04.05.2023, ka refuzuar ankesat e PSRK-së dhe të pandehurëve dhe mbrojtësve të tyre dhe ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

Ajo që mund të veçojmë si pozitive gjatë kësaj periudhe tremujore është fakti se konfiskimet, ngrirjet dhe sekuestrimet kanë ndodhur për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë vepra penale kundër korrupsionit (keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar), krimeve ekonomike (ndër tjera edhe për shpëlarjen e parave), veprat penale kundër narkotikëve, armëve, grabitje, falsifikimi i dokumentit, veprave terroriste, etj..

Madje, tek vepra penale e shpëlarjes së parave, mbetet fakt jashtëzakonisht pozitiv që edhe këtë vit, ashtu sikurse edhe në vitin 2022, kemi sukses të lakmueshëm. Kështu, rasti me konfiskimin më të madh që ka ndodhur ndonjëherë, përfshin mes tjerash edhe një dispozitiv të aktakuzës dhe aktgjykimit dënues, edhe për veprën penale të shpëlarjes së parave, kësaj here së bashku me veprat penale bazë.

Një sukses tjetër i jashtëzakonshëm është rasti me konfiskim që vjen nga PSRK (PPS.nr.88/2020, aktakuzë e ngritur me dt. 12.10.2021). Në këtë rast ishte vjedhur buxheti i shtetit në vlerë prej 2.1 milionë euro, mirëpo si shkak i veprimeve të policisë dhe prokurorisë, ia kemi dalë që në këtë rast të rëndë, të rikuperohet shuma prej gati 1 milionë euro, duke përfshirë edhe konfiskimin e 4 veturave të shtrenjta.

Këto tri raste, e posaçërisht dy rastet që vijnë nga PSRK, janë raste të mëdha, domethënëse dhe raste që nëse përsëriten më shpesh, do të arrijnë të realizohen shumë qëllime, duke filluar nga rritja e imazhit të prokurorisë në sistemin e drejtësisë para së gjithash, parandalimin e kryesve të veprave penale dhe parandalimin e kryesve tjerë, forcimin e moralit në shoqëri, kompensimin dhe përcimin e mesazhit kryesor e që është ajo se KRIMI NUK SHPAGUHET.

Më pas është edhe një fakt tjetër pozitiv që tregohet përmes faktit se 32 prokurorë janë përfshirë në sekuestrim apo ngrirje të pasurisë në raste të ndryshme.

-Trendi i zgjidhjes së rasteve të krimeve ekonomike në raport me ato të pranuar gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, është negativ. Kështu, të dhënat statistikore dëshmojnë se këtë tremujor janë pranuar gjithsej 91 raste të reja me 109 persona, ndërsa që janë zgjidhur 75 raste me 100 persona. Edhe më saktë, duke përdorur

përqindjen, del se prokuroritë kanë zgjidhur 82.41% të rasteve të pranuar dhe 91.74% të rasteve me persona gjatë TM2 të vitit 2023.

-Më tutje, përderisa jemi ende te kjo çështje, është interesante të shihet se nga totali prej 100 rasteve të zgjidhura me persona në TM2, prokuroritë themelore dhe PSRK, së bashku, kanë vendosur të ngrisin aktakuza kundër 81 personave, apo në 81%, ndërsa kanë vendosur të pushojnë hetimet kundër 8 personave apo në 8% të tyre si dhe kanë hedhur kallëzimet penale kundër 11 personave apo në 11% të tyre.

- Te vepra penale e shpëlarjes së parave në TM2 të vitit 2023 kemi pasur 0 kallëzime penale të reja të pranuar kundër 0 personave, ndërsa që janë zgjidhur 1 rast me 3 persona. Pra, sikur që vërehet, PSRK ka zgjidhur më pak raste se sa janë pranuar sa u përket kallëzimeve penale, si me raste ashtu edhe me persona.

-Ndërsa kur jemi te vendimet e gjykatave paraqitet një situatë pozitive ngase kemi 33 vendime nga ana e gjykatës. Nga numri prej 33 personave, gjykatat kanë marrë aktgjykime fajësuese kundër 24 personave, në 4 raste është hedhur aktakuza para shqyrtimit gjyqësor, në 3 raste të akuzuarit janë liruar nga aktakuzat dhe në 2 raste është refuzuar aktakuza. Pra, nga totali prej 33 vendimeve për persona, në 72.72% të tyre gjykatat kanë shpallur personat fajtor sipas aktakuzave, në 12.12% të rasteve janë hedhur aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor, në 9.09% të rasteve të akuzuarit janë liruar nga akuzat dhe në 6.06% është refuzuar aktakuza.

-Tek rastet e evidentuara si INFORMATA apo PPN-të, në TM2 të vitit 2023 janë pranuar 29 raste kundër 29 personave, ndërsa janë zgjidhur 20 raste kundër 20 personave.

3. KONSTATIMET

Periodha që përfshin tremujorin e dytë të vitit 2023 paraqet një tablo pozitive dhe me suksesin më të madh në 10 vitet e fundit. Ky tremujor jo vetëm që është tremujori më i suksesshëm, por është edhe tremujori me më shumë konfiskim se sa madje 5 vitet e fundit së bashku.

Këtë e pasqyron fakti se ka tri raste me konfiskim final, në shumë prej 3,557,891.64 € pasuri të konfiskuara dhe 257,320.45 € pasuri të sekuestruara, 62,794,963.98 € pasuri të ngrira.

Progres mund të konsiderohet edhe fakti se bëhet fjalë për tri raste, dy nga të cilat janë raste të mëdha dhe me peshë.

4. LIGJI MBI KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT

LKZK e re ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Çdo aktgjykim që merret pas datës së hyrjes në fuqi, ka mundësi që LKZK e re të aplikohet dhe kjo paraqet një mundësi të mirë për sistemin gjyqësor të vendit që shifrat e konfiskimeve t'i rrisë duke shfrytëzuar këtë ligj që është shumë më i fuqishëm se sa ai i kaluari.

Kështu, PTH Peja, ka 4 raste në proces e sipër sipas këtij ligji.

Në rastin PP.I.nr.250/22, është ngritur tashmë aktakuza e dt. 14.12.2022, kundër të pandehurit N. I., për shkak të dyshimit se është kryer vepra penale e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së pautorizuar të narkotikëve nga neni 267.2 i KPRK-së. Me dt. 20.12.2022, është iniciuar hetimi për konfiskimin, ndërsa me dt. 22.12.2022, është lëshuar Urdhi Kufizues i Përkohshëm për një lokal prej 79m². Me dt. 28.12.2022, është parashtruar kërkesa për lëshimin e Urdhit Kufizues Përfundimtar.

Në rastin tjetër, PP.II.nr.1927/19, ka pasur disa zhvillime, ku fillimisht është refuzuar kërkesa e prokurorisë për zbulim të disa akteve e që pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit ka aprovuar pjesërisht kërkesën e prokurorisë.

Në rastin e PTH Prizrenit, aktakuza PP/II.nr.1214-14/21, është ngritur me date 11.05.2023 dhe gjykata ende nuk ka caktuar shqyrtimin fillestar.

Katër rastet e PTH Pejës janë nën shifrat:

PP/I nr. 250/22;

PP/I nr. 1927/19;

PP/I nr. 589/21; dhe

PP/I nr. 230/21.

RAPORT TREMUJOR

Prill – qershor 2023

5. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Legjislacioni:

Koncept dokumenti për ligjin e PPP/LFT, Hartimin e Projektligjit për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, Hartimin e vlerësimit të rrezikut të Financimit të Terrorizmit sektorial të OJQ-ve.

Operacionet:

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer 1 inspektim/ekzaminim në fushën PP/FT në institucionet financiare si në vijim:

1. NLB Bank.

Bashkëpunimi dhe trajnimet:

- Gjatë kësaj periudhe stafi i divizionit PPP/FT ka marrë pjesë me grupin punues për vlerësimin e rrezikut sektorial të OJQ-ve në Strasburg tek Këshilli i Evropës, në muajin maj.

6. NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Sipas mandatit të vet ligjor misioni i Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NjIF-K), është të udhëheqë përpjekjet e Qeverisë për përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar. Funkcionimi i duhur i sistemit si tërësi, përmes bashkëpunimit të ngushtë institucional dhe aktiviteteve të Njesisë për Inteligjencë Financiare është objektiva kryesore e NjIF-K.

Me datë 29-30 maj 2023 është mbajtur takimi i Grupit Punues Parlamentar për iniciativën ligjore që synon rregullimin e krypto-aseteve në funksion të përafrimit dhe zbatimit të tij me standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare në zhvillim në fushën Kundër Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit. Në këtë drejtim, 25 përfaqësues nga Kuvendi, ministritë e linjës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Banka Qendrore, Policia, Administrata Tatimore, Doganat, sektori privat dhe odat ekonomike, ekspertë të Këshillit të Evropës, morën pjesë në diskutimet vijuese të Grupit të Punës Parlamentare për shqyrtimin e projektligjit për krypto-asetet. Pjesëmarrësit diskutuan rregullimin e asetëve virtuale dhe ofruesve të shërbimeve të asetëve virtuale dhe mekanizmat e zbatimit për të siguruar zbatimin e legjislacionit LPP/LFT.

Më 16 dhe 17 maj 2023 është organizuar trajnim për implementimin e ligjit për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të ofrojë kontakt me institucionet përkatëse kompetente dhe subjektet raportuese dhe të rrisë ndërgjegjësimin për standardet ndërkombëtare dhe zbatimin e legjislacionit vendas për sanksionet e synuara financiare.

Me datë 4 dhe 5 maj 2023 anëtarët e Ekipit Analitik dhe Koordinues për vlerësimin e rrezikut sektorial në financim të terrorizmit në sektorin e OJQ-ve, kanë mbajtur takim në Strasburg për të prezantuar dhe diskutuar analizën dhe sintezën e informacionit të marrë përmes moduleve të mbledhjes së të dhënave dhe

hulumtimit. Pjesëmarrësit që përfaqësojnë Njësinë e Inteligjencës Financiare, Këshillin Prokurorial, Bankën Qendrore, Policinë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamentin për Regjistrimin e OJQ-ve, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shoqatën e Bankave, Doganat, Tatimet, Agjencinë e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë e Inteligjencës dhe Shoqërinë Civile, diskutuan rekomandimet dhe morën këshilla për draft-vlerësimin e mëtutjeshëm të ndërmarrë dhe këshilla për t'u marrë në draft raportin përfundimtar.

Me 19 dhe 20 Prill 2023, është përmbyllur me sukses aktiviteti i mentorimit të mbikqyrjes së bazuar në rrezik i mbështetur nga Projekti i Këshillit të Europës (PECK III). Qëllimi i programit të mentorimit ishte që të ofroj udhëzime praktike dhe këshilla të ekspertëve për proceset e vazhdueshme operative që kanë të bëjnë me mbikqyrjen e LPP/LFT jashtë dhe në vend të subjekteve të obliguara. Pjesëmarrësit nga Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Banka Qendrore pranuan ndikimin pozitiv që ka shkëmbimi peer-to-peer në përmirësimin e praktikave mbikqyrëse në Kosovë duke forcuar më tej qasjen e bazuar në rrezik në përputhje me standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu se një qasje e bazuar në rrezik do të integrohet në të gjitha aspektet e hartimit të një programi mbikqyrës.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur një sërë takimesh të Sekretariatit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2024-2028.

Me datë 8 dhe 9 Qershor 2023, Shoqata e Bankave në bashkëpunim me NJIF-K dhe BQK ka organizuar punëtorinë "Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit".

Me datë 22 qershor 2023, është mbajtur takim me Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës, mbështetur nga Programi i USAID-it - Drejtësia Komerciale.

Më 16 qershor 2023 është mbajtur një tryezë diskutimi me temë: "Sfidat e luftimit dhe parandalimit të pastrimit të parave në Kosovë". Kjo tryezë është organizuar nga Fondacioni gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ).

Nga data 5 deri më 9 Qershor 2023, është zhvilluar një vizitë vlerësuese e Zyres së Asistencës Teknike të Thesarit të SHBA-ve.

Më 14 -16 qershor 2023, Misioni i OSBE në Kosovë, ka organizuar trajnim të avancuar dhe të specializuar në kontabilitet dhe aftësi analitike në hetimin e integruar të krimeve financiare.

Ne këtë periudhë, stafi profesional i NJIF-K kanë marrë pjesë në trajnime, punëtori vendore dhe ndërkombëtare si në vijim:

- Menaxhimi i performancës, IKAP;
- Zbatimin e Ligjit për Sanksionet e Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, PECK III;
- Mësimet e nxjerra nga mentorimi mbi mbikqyrjen e bazuar në rrezik për Parandalimin e Pastrimit të Parave/Luftimin e Financimit të Terrorizmit me NJIF dhe BQK, PECK III
- OSINT Open Source Intelligence, GIZ
- Trajnim i avancuar dhe i specializuar në kontabilitet dhe aftësi analitike në hetimin e integruar të krimeve financiare, OSCE
- Regional FIU Directors Meeting, Tiranë, GIZ

Gjatë kësaj periudhe është lëshuar 1 Urdhër për ngrirje të transaksioneve në vlerë prej rreth 59,883 Euro. Gjithsej 53 raporte për shkëmbim të informacionit janë ndarë me agjencionet e zbatimit të ligjit.

Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar është një nga objektivat strategjike të NJIF-K. Zyrtarët e NJIF-K kanë marrë pjesë në takimin e drejtorëve të FIU-ve të vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur me datë 6 dhe 7 qershor 2023, në Tiranë, Shqipëri.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë shkëmbyer 24 informata me homologët e huaj ndërkombëtar.

7. POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës ka raportuar se gjatë këtij tremujori të dytë ka pasur këto aktivitete të trajnimit:

Nr.	Emertimi	Organizator	Nr.trajnimeve	Pjestar
1	Trajnimi Etika ne administratën Publike (Parandalimi i konfliktit të interesit dhe i korrupsionit)	IKAP	1	1
2	Projekti kundër Krimin Ekonomik (PECK III)	BE & PECK III (Këshilli i Evropës kundër Krimin Ekonomik)	1	1
3	Punëtori-Luftimi i Korrupsionit për Prokurorët, gjyqtrarët dhe hetuesit Policorë	OPDAT	1	6
4	Trajnim Pastrimi i parave dhe hetimet financiare	OPDAT & ICITAP	1	7
5	Trajnim i Avancuar Kontabilitet dhe aftësi analitike në hetimin e integruar të krimeve financiare	OSBE	1	3
6	Trajnim Lufta Kundër Financimit të Terrorizmit	OSBE	1	5
7	Trajnim Metodën e pavarur të hetimit të integruar dhe metodën e re të operimit për pastrimin e parave	OSBE	1	3
8	Ëbëinar Depoja e mjeteve të Europolit: ndikimi operacional i inovacionit	CEPOL	1	4
Totali			8	30

Nr.	Aktivite te mbajtura jashtë vendi	Vendi	Organizator	Nr.trajnimeve	Pjestar
1	Trajnim Programi i ndërgjegjësimit te hetimit financiar kundër terrorizmit për ligj zbatuesit ndërkombëtarë	Britania e Madhe	Ambasadën Britanike	1	1
2	Grupi punues për vlerësimin e të dhënave të grumbulluara lidhur me rreziqet e financimit të terrorizmit (FT) në sektorin e organizatave jo fitimprurësve (OJF)	Franca	BE & PECK III (Këshilli i Evropës kundër Krimin Ekonomik)	1	1
3	Takim Strategjik për luftimin e flukseve të paligjshme financiare	Maqedonia	GIZI Gjerman	1	1

Totali	3	3
---------------	----------	----------

8. STATISTIKAT E NGRIRJEVE, SEKUESTRIMEVE DHE KONFISKIMEVE

Ngirirjet, sekuestrimet, dhe konfiskimet për tremujorin e dytë për vitin 2023

Sekuestrim:

Gjatë periudhës raportuese të tremujorit të dytë (prill-qershor) për vitin 2023, janë sekuestruar si në vijim:

- 35 automjete.....171,814.30 €
- Para kesh55,620.00 €
- Të tjera (duhan, kafshë, pajisje të ndryshme, masë drunore, orë dore, lap top, veshmbathje etj.).....29,886.15 €.

Ngirirje:

- Ngastra kadastrale42,000,000.00 €
- Ngastra kadastrale20,000,000.00 €
- Ngastra kadastrale.....600,000,00 €
- 4 lokale afariste, 1 apartment.....190,055.00 €
- 1 Automjet.....4908.98 €

Konfiskim:

- Sipas raportit zyrtar të ekspertit financiar, vlerësimi i ekspertizës është si në vijim:
 1. Vlera e blerjeve të patundshmërive-palujtshmërive.....1,139,000.00 €
 2. Vlera e automjeteve.....508,000.00 €
 3. Vlera e kredive të kthyera.....671,501.78 €
 4. Kredit e kthyera në një institucion financiar.....64,226.20 €
 5. Transferet – mjetet e pranuar nga një institucion financiar60,911.00 €
 6. Transferet – mjetet e pranuar nga një institucion financiar145,076.36 €
 - **TOTALI:****2,588,715.34 €**

- Para.....944,631.40 €
- Automjete.....24,544.90 €

Sekuestrime janë: 257,320.45 €

Ngrirje janë: 62,794,963.98 €

Konfiskime janë: 3,557,891.64 €

Totali i konfiskimit, sekuestrimit, ngrirjes 66,610,176.07 €

Janë bërë 6 kërkesa për shitje të automjeteve

P.Th. Prizren PPN/II.nr.396-14/2022,

P.Th. Pejë PP/II.nr.2332/19, PP/II.nr.2311/2020, PP/II.nr.1038/2025,

PP/II.nr.2474/16, PP/II.nr.568/2021

9. SEKUESTRIMET PËR TREMUJORIN E II-rë TË VITIT 2023

Nr.	Nr. i Prokurorisë	Vepra penale	Përshkrimi i pasurisë	Prokuroria	Data
1	PPN/II.nr.178/23	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Automjet Masë drunore	P.Th. Ferizaj	22.05.2023
2	PP/II.nr.656/23	Vjedhje e rëndë neni 315 par.1 nën par 1.1 par 2 nënpar 2.1 lidhur me nenin 77 dhe nenin 31 të KPRK-së	Ora dore	P.Th. Ferizaj	21.06.2023
3	PPN/II.nr.145/23	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Tjera Masë drunore	P.Th. Ferizaj	03.05.2023
4	PP/II.nr.748/2023	Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje neni 315 par.2 nën par 2.2 lidhur me nenin 1 nënpar 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së	Automjet Para	P.Th. Gjakovë	06.06.2023
5	RLN/II.nr.78/21	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Lap top	P.Th. Gjakovë	20.05.2021
6	PP/I.nr.51/2023	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Automjet Para	P.Th. Gjakovë	07.04.2023
7	PPN/I.nr.124/2023	Grabitja neni 317 të KPRK-së	Automjet	P.Th. Gjakovë	21.06.2023
8	PPN/II.nr.197/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Duhan	P.Th Gjilan	10.05.2023
9	PP/II.nr.739/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Duhan	P.Th Gjilan	10.05.2023
10	PPN/II.nr.225/2023	Kontrabandim i mallrave neni 311 të KPRK-së	Automjet Kafshë	P.Th Gjilan	25.05.2023

11	PP/II.nr.650/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet Kafshë	P.Th Gjilan	24.04.2023
12	PPN/II.nr.166/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Duhan	P.Th Gjilan	25.04.2023
13	PP/II.nr.560/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet Kafshë	P.Th Gjilan	04.04.2023
14	PP/II.nr.852/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th Gjilan	29.05.2023
15	PPN/II.nr.167/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Duhan	P.Th Gjilan	28.04.2023
16	PPN/II.nr.162/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Kafshë	P.Th Gjilan	20.04.2023
17	PP/II.nr.636/2023	Kontrabandim i mallrave neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th Gjilan	27.04.2023
18	PP/II.nr.688/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet Duhan	P.Th Gjilan	02.05.2023
19	PP/II.nr.571/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Kafshë	P.Th Gjilan	19.04.2023
20	PP/I.nr.67/2023	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prizren	17.05.2023
21	PP/I.nr.81/23	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	27.04.2023
22	PP/II.nr.626/2023	Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 të KPRK-së, Fajde neni 331 të KP	Automjet Cigare	P.Th.Mitrovicë	12.05.2023
23	PP/II.nr.673/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet Pajisje të ndryshme	P.Th.Mitrovicë	18.05.2023
24	PP/II.nr.805/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	06.06.2023
25	PP/II.nr.804/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	07.06.2023
26	PP/II.nr.814/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	12.06.2023
27	PP/II.nr.813/2023	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	13.06.2023
28	PP/II.nr.956/23	Falsifikim i dokumenteve neni 390 par 1 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	29.06.2023
29	283/II.nr.283/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet Veshmbathje	P.Th.Mitrovicë	14.04.2023
30	PP/II.nr.492/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	18.05.2023
31	PP/II.nr.493/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	15.05.2023
32	PPN/I.nr.77/2023	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Para	P.Th. Pejë	06.04.2023
33	PPN/II.nr.298/23	Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së	Automjet	P.Th. Pejë	13.04.2023
34	PP/II.nr.684/23	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Masë drunore	P.Th. Pejë	13.04.2023
35	PPN/II.nr.323/2023	Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së	Automjet	P.Th. Pejë	18.04.2023
36	PPN/II.nr.447/2023	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Automjet Masë drunore	P.Th. Pejë	13.04.2023
